



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. F52

Vlorë, më 28. 03. 2018

VENDIM

Nr 12, datë 21/03 /2018

PËR SISTEMIMIN E FËMIJËS XH.B NË SHTËPINË E FOSHNJES 0-6 VJEÇ VLORË

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 21 / 03 /2018, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të VKM nr.425, datë 27.6.2012. “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale , publike dhe jopublike , të përkujdesjes shoqërore” (Ndryshuar me VKM nr.839, datë 3.12.2014; nr.106, datë 15.2.2017), të Ligjit Nr.10 347 datë 04/11/2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijës”, Udhëzimit Nr. 6 dt. 21/05/2014 “Për procedurat e sistemimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publike dhe jopublike”, kërkesës me nr.284 prot dt.26/01.2018 të Bashkisë Himarë dhe referimit të bërë nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Himarë, hyrë në Këshillin e Qarkut Vlorë me nr.296 prot. me date 31/01/2018.

VENDOSI;

Fëmija XH.B të sistemohet në institucionin: Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç, Vlorë.

KRYETARI

Ervis MOÇKA



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me nr. _____, datë ____/____/2018

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Sheshi “4 Heronjtë”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Të nderuar Këshilltarë!

Pas informacionit të marrë nga kryetari i fshatit Çorraj për gjendjen e fëmijës Xh.B , u bë verifikimi nga bashkia Himarë i situatës në familjen Balilaj nga punonjësja e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve , Punonjësi i Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Njerëzve në Nevojë , përfaqësues nga Qendra Shëndetësore dhe Policia Bashkiake . Vajza është e ditëlindjes 20/04/2013, prindërit janë të divorcuar . Me vendim gjykate kujdestaria iu la nënës , e cila pas këtij Vendimi mbajti disa ditë të bijën dhe e braktisi duke e kthyer pranë familjes së ish – bashkëshortit me pretekstin se s’ka mundësi ta mbajë (vendndodhja aktuale e nënës nuk dihet). Babai i vajzës më datë 06/03/2017, bëri Kërkesë Ankimore për ndryshimin e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për sa i përket përgjegjësisë prindërore , ku kërkoi që kujdestaria e së bijës t’i kalohej atij pasi vajza jeton në Çorraj. Ai është një person me probleme shëndetësore dhe mendore (referuar përgjigjeve mjekësore bashkangjitur këtij relacioni), si dhe ka probleme me alkolin . Në banesë, kushtet e së cilës janë të papërshtatshme, jetojnë Xhevit Balilaj me të bijën Xh.B , vëllai i Xhevitit i cili është çoban dhe dy prindërit (pensionistë) të Xhevitit.

Të ardhura kjo familje ka vetëm nga pensionet e prindërve të Xhevitit , të cilët kanë dhe probleme shëndetësore.

Duke pasur në fokus interesin më të lartë të fëmijës , nisur nga mosha e saj shumë e vogël, kushtet e papërshtatshme për rritjen e saj, pamundësia e familjarëve për t’u kujdesur kërkojmë vendosjen e fëmijës Xh.B në Institucion.

Shpresojmë të gjejmë mbështetjen tuaj!

Specialiste:

Anila Hitaj

Juriste

Alma Myrtaj